



Viti 2011 nuk ishte një vit i zakonshëm...

Stinëve të vitit iu shtua edhe një stinë, stina e burrave...

Kështu stinët e vitit u bënë pesë...

Lamtumirë 2011...

Nga ti mësuam shumë...

Dhe shumë të tjera na ke lënë për t'i mësuar...

Na mësove se ne kemi një vatan të madh...

U çliruar pasi tërhiqeshim si Gomar...

Lamtumirë 2011...

Lamtumirë viti i dëshmorëve dhe tekbireve ...

Lamtumirë viti i gjakut të parfumuar...

Lamtumirë o vit i vdekjes së foshnjave në moshën e zogjve...

Lamtumirë o vit i brohoritjeve të përziara me të qarë të hidhur...

Lamtumirë o vit i emergjencës, izolimeve dhe rezolutave...

Lamtumirë o vit i portës Azizije, rrugës Ebu Rekibe dhe sheshit Tahrir...

Lamtumirë o vit i topave, tankeve dhe derrave...

Lamtumirë o vit i gjeneralëve te sinqerte...

Lamtumirë o vit i përfundimit te mercenares, dhe fallxhorëve të ndytë që nuk sollën për vatanin e tyre veçse shkatërrim...

Lamtumirë o vit i mbytjeve me plumba dhe djegie me eksploziv...

Lamtumirë o vit i tërheqjeve dhe gjykimeve...

Lamtumirë o vit i ikjeve masive...

Lamtumirë o vit i ndryshimit...

Nga ti kemi mësuar shumë...

Por edhe shumë të tjera na ke lënë për t'i mësuar...

Përktheu: Valdet Kamberi